



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 8301 / Prot.
16

Patos më 20.03.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 19.03.2025

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Armand Ahmetaj
2. Suela Hoxha
3. Liljana Mesutaj
4. Vjollca Kasaj
5. Elmira Rama
6. Artan Velçani
7. Ertilla Myrtaj
8. Klarida Semanjaku
9. Renaldo Shpata
10. Erald Çepele
11. Lori Musaj
12. Smerald Hazizaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar anëtar koleg këshilltarë!

Të nderuar qytetar!

Zhvillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak. Mbledhja është e bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53 pika 4 dhe 56 pika 2 gërma a.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 12 këshilltarë. Para se të lëxoj rendin e ditës keni për të shtuar apo për të hequr ndonjë pikë nga rendi i ditës. Nëse s’keni vazhdojmë me leximin.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 26.02.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 26.02.2025.

4- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2025”.

5- Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2025”.

6- Projekt-vendim "Mbi miratimin e tavanëve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".

7- Projekt-vendim "Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 264/24 prot., datë 30.01.2025 me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë".

8- Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024"

9- Projekt-vendim "Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024".

10- Informacion për Inventarët jashtë përdorimit nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Pika 4, 5, 6 ,7 kanë kaluar në komision në datën 18.03.2025.

Kalojmë në miratimin e rendit të ditës?

Armand Ahmetaj- Kush është dakord?

Miratohet me 12 vota pro abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerod Hoxhaj
Erbila Myrtaj
Artan Selcari

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 830 / Prot.
17

Patos më 20 .03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 26.02.2025.

Armand Ahmetaj –, keni ndonje verejtje ndonjë paqartësi, ndonjë korrigjim për procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Nëse s'keni me pelqim unanim neni 77 i rregullores miratohet procesverbali.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerod Hazriq
Edila Myrtaj
Artan Velser

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 8301 Prot.
18

Patos më, 20 03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 26.02.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën.

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 26.02.2025 janë marrë gjithsej 6 vendime. Nga nr. 6 deri në nr 11.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Gjithashtu më lejoni t'ju informoj se nga ana e prefekturës kemi pasur një kontroll në vend në datën 05.03.2025, ku objekti i kontrollit ishte:

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të Bashkisë Patos, për periudhën dhjetor 2024 shkurt 2025.

Ndjekja e vendimeve të kthyera nga Prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt verifikimi.

Nga kontrolli i ushtruar përfundimet janë si më poshtë vijon:

Për periudhën dhjetor 2024 - shkurt 2025 nuk ka akte normative të padepozituara për verifikim ligjor te Prefekti i Qarkut Fier.

Për periudhën dhjetor 2024 shkurt 2025 nuk ka akte të kthyera nga Prefekti i Qarkut Fier si akte në kundërshtim me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 8221 Prot.
13

Patos më 20 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2025”.

Armand Ahmetaj- Ekzekutivi relaton dhe më pas e ka fjalën komisioni i ekonomisë.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Përshëndetje! Projektvendim nr. 13 datë 13.03.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2025”.

Ekzekutivi propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Janar 2025 gjithsej 17 familje me një fond prej 69,221 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzetë e një) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Erald Çepele- 16 emra janë përfitues?

Elda Goxhaj- 17 emra, një sekond të lutem, madje ishim shumë të lumtur se kjo ishte vlera më e lart e fondit që kemi pasur ndonjëherë dhe nuk u përjashtua asnjë. 16 janë.

Suela Hoxha- Tani ndaje është 16 apo 17?

Kryetari i Bashkisë- Tani familje janë 16 sipas listës emërore, ka një lapsus që është shënuar 17 por lista emërore prevalon mbi lapsusin e bërë.

Suela Hoxha- domethënë janë 16 familje?

Rafaela Xeba- Kur të zbardhet vendimi e saktësojmë.

Elda Goxhaj- Në vijim dhe të fjalës së kryetarit familje përfituese janë 16, relacioni është i saktë do ta saktësojmë tek pjesa e vendimit.

Lori Musaj- Përshëndetje të gjithëve- Komisioni e konstaton projektvendimin në përputhje me ligjin dhe e kaloi me 3 vota pro.

Armand Ahmetaj – Kush është dakord? Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2025”.

Suela Hoxha- Meqënëse Projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shkurt 2025”, është një projektvendim i vulosur me firmë nga juriste Nurkë, Barie Goxhaj dhe drejtoresha Elda Goxhaj ju lutem shumë nuk ka mundësi se si bëhet një lapsus për një emër ndërkohë që kjo duhet të ishte e mirë studiuar që do të thotë 16 emra aty dhe 17 këtu ose do dali një projektvendimi i ri tani i vulosur dhe ta miratojmë nesër sepse këtu thotë 17 dhe këtu 16 emra ska pse të ndodhi.

Armand Ahmetaj- duhet të ishte pak më e vëmendshme sepse morën dhjetë minuta kohë për ta sqaruar.

Suela Hoxha- Dua një arsye pse ka shtatëmbëdhjetë dhe 16 janë në listë?

Elda Goxhaj - është gabim njerëzor.

Kryetari i Bashkisë- është lapsus.

Armand Ahmetaj- Numri 17 është lapsus, 16 që janë në listë është lista e saktë.

Suela Hoxha- Pikërisht këta tre përgjegjës si nuk e kanë vënë re këtë 17?

Armand Ahmetaj- Këtë që po bëjmë ne këtu e kemi te dokumentuar dhe është pjesa ligjore.

Suela Hoxha- Tre veta nuk kanë qënë të aftë të përcaktojnë numrin 17 ka 16.

Armand Ahmetaj- Je totalisht gabim.

Suela Hoxha- është e zezë mbi të bardhë.

Elmira Rama- Në lidhje më numrin unë po verifikojë edhe shumën dhe shikoj që shuma për numër 16 është 69,221 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzetë e një) lekë ndërkohë që ne kemi numrin 17 që patjetër është lapsus kur shuma është 69,211.

Suela Hoxha- Pse duhet të bëhët gabimisht pra, këtu jemi në nivel zyrtar dhe këto janë projektvendime të miratuara ska pse të këtë gabime të tilla as në numra as në shifra dhe as në interpretim.

Armand Ahmetaj- E sqaruam pra.

Armand Ahmetaj- Ne jemi të qartë.

Miratohet me 11 vota pro, abstenim ska, kundër 1.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smirë Hoxha
Elda Goxhaj
Anton Veljevi

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 823/Prot.

3

Patos më 20 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2025”.

Elda Goxhaj Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social- Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Shkurt 2025 gjithsej 30 familje me një fond prej 129,351 (njëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e një) lekë. Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit bashkëngjitur.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Erald Çepele- Nga herët e tjera kur vinte projektvendimi vinte dhe nga janë këta personat, unë nga mbiemri nuk shoh këtu të ketë ndonjë nga Zharrëza.

Elda Goxhaj- Urdhëro adresën e banimit.

Erald Çepele- Nuk ka pasur kërkesa nga njësia Zharrëz apo janë skualifikuar?

Elda Goxhaj- Në fund fare të tabelës, te vlerësimi është adresa e banimit.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera kalojmë në miratim. Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin Shkurt 2025”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?

Miratohet me 12 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 821/Prot.
13

Patos më 20.03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Mbi miratimin e tavanëve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Armand Ahmetaj- Ftojmë ekzekutivin

Mimoza Shtëmbari – Drejtore e Finacës - Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, 2 udhëzime që janë 1 udhëzim standart të përgatitjes së buxhetit afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 08 datë “Për Përgatitjen e Buxhetit 2026-2028” grupi i menaxhimit pasi ka bërë analizën sipas burimeve financiarë të miratuara me vendimin e këshillit nr. 03 datë 26.02.2025 për vlerësimin dhe parashikimin e atë ardhurave, ka bërë detajimin e tavanëve sipas programeve në buxhetin afatmesëm të tavanëve përgatitore 2026-2028.

Burimet që përbëjnë Buxhetin AFM dhe që janë objekt i miratimit me vendim të këshillit për buxhetet vendore janë:

Transferta e pakushtëzuar që vjen me një rritje për vitin 2026, 6 milion e 400 mijë po kështu dhe për 2027 dhe 2028.

Kemi rritjen e nivelit të pagave që financohet me nivel të pandryshueshëm me 2025.

Kemi funksionet specifike të pandryshuara sipas alokimit sipas udhëzimit vjetor kemi dhe të ardhurat vendore të cilat vijnë me rritje gati 1% në vlerë absolute.

Shpërndarja e shpenzimeve për çdo program është bërë duke marrë sipas viteve të mëparshëm që do të thotë vitin 2025 vitin aktualë me 1% rritje 2026 2% për 2027 2 për 2028 e cila përkërkon me rritjen e nivelit të të ardhurave për gjithë buxhetin afatmesëm.

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2026 -2028 është bërë në bazë të shtojcës 5 të vitit 2025 i cili ka ardhur për përgatitjen e tavanëve dhe ne jemi një nga bashkitë pilotë që jemi pilotuar për të hartuar buxhet nga 20 programe për ta grupuar në gjashtë programe dhe të gjashtë programet do të mbulohet financimi i 36 funksioneve që mbulon pushteti vendor sipas 139. Grupi i menaxhimit pasi ka bërë analizat ka mbajtur prioritet që investimet të jënë në rritje nga viti në vit për këtë PBA dhe kjo është sipas relacionit nga 25% 27, 28% në vitin e fundit të PBA-së.

Shpenzimet e personelit kanë ruajtur të njejtin nivel në 2026 dhe në 2026-2028 duke qënë se alokimi për funksionet sektoriale ose specifike ka ardhur pa ndryshuar dhe ne nuk kemi bërë ndryshim, e kemi lënë në të njejtin nivel për 2026 dhe për 2027, 2028. Gjatë vazhdimit dhe zbatimit të të gjithë fazave sipas kalendarit të miratuar nga këshilli për përgatitjen e buxhetit afatmesëm ne do të bëjmë dhe reflektimin sipas ndryshimeve që do të vij nga burimet. Prioritetet që ka vendosur bashkia janë të shoqëruara në realacion e projektvendimit dhe treguesit financiarë që shoqërojnë këtë PBA janë 48% është një tregues pozitiv që 48% kemi arritur të mbulojmë me të ardhurat vendore në buxhetin total dhe nga këto 25% shpenzimet kapitale siç referova 49 % shpenzimet e personelit dhe pjesa tjetër është për shpenzime operative.

Në bazë të ligjit për krijimin e fondit rezervë dhe kontigjencës kemi buxhetuar me vlera të pandryshuara në tre vjet të cilat mund të ndryshojnë gjatë fazave të mëvonshme duke ruajtur nivelin e ligjit deri në 3% të buxhetit.

Ky ishte projektvendimi dhe relacioni tabelat shoqëruese kanë përmbajtje në gjithë buxhetimit në gjashtë programe ku pesë programe janë shpërndarja e tridhjetë e gjashtë funksioneve dhe një program është fondi i kontigjencës dhe rezervë gjithashtu është dhe tabela sipas instrumentit financiar e PBA 2 ku janë të gjitha të ardhurat ndër vite deri në vitin 28 të planifikuara dhe të miratuara nga ju me vendim këshilli në shkurt të 2025.

Lori Musaj -komisioni ekonomisë ka diskutuar mbi këtë projektvendim dhe konstaton se përmbajtja është në përputhje me bazën ligjore dhe ne e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro.

Faleminderit!

Armand Ahmetaj – Dua tju informoj se pjesëmarrja e këshilltarëve është shtuar më një këshilltar z. Klaudio Alisininaj.

Armand Ahmetaj – Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim Mbi miratimin e tavanëve përgatitor të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.


Miratohet me 13 vota pro, kundër ska , abstenim ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba



Smerodol Hoxhaj
Echila Myrtaj
Artan Veliaj

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 825/Prot.
13

Patos më 20 03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 264/24 prot., datë 30.01.2025 me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”.

Ermenita Mici- Në thirrjen e hapur nga Ministria e Ekonomisë bashkia Patos ka aplikuar në programin përmirësimi kushteve të banesave ekzistuese për familjet në nevojë.

Janë verifikuar nga grupi i punës të gjitha banesat sipas kërkesave të ardhura në bashkin Patos janë hartuar procesverbalet përkatëse të konstatimit të gjendjes së tyre si dhe në bazë të vlerësimit të bërë në bazë të ligjit të strehimit janë hartuar projekt preventivat për 20 banesa vlera investimit në këto 20 banesa arrijnë vlerën 13 milionë e 637 mijë e 105.80.

Bazuar në udhëzimin e ministrit numër 31 është përcaktuar dhe vlera e bashkëfinancimit për bashkinë Patos e cila është 30% dhe përcaktohet nga niveli të ardhurave për frymë.

Në këto kushte i kërkojmë këshillit të bashkisë:

Miratimin e listës së familjeve në nevojë të përfshira në aplikimin e projektit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, me vlerë 13,637,105.80 (trembëdhjetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesë pikë tetëdhjetë) lekë.

Miratimin e fondit të bashkëfinancimit, 30% e vlerës së investimit, për 20 banesa. Fondi do të mbulohet brenda programit të strehimit social.

Kryetari i Bashkisë- Jo domosdoshmerisht kjo do shkoj më miratimin dhe ndërhyrjen tek të gjitha këto familje sepse është dicka që varet nga Minsitria Përkatëse. Nëqoftë se projekti do të përfitohet nga Minsitria do dali fitues atëherë do vahdohet me hapa të mëtejshme, kjo është faza fillestare.

Lori Musaj- komisioni ekonomisë ka diskutuar mbi këtë projektim dhe konstaton së përmbajtja është në përputhje me bazën ligjore dhe ne e kemi votuar pa asnjë ndryshim me tre vota pro Faleminderit!

Elmira Rama- Cila do të ishte pengesa që do conte në mosmiratimin e këtij projekt

Kryetari Bahksië- Varet nga Ministria.

Armand Ahmetaj – Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e listës së familjeve të përfshira në aplikimin nr. 264/24 prot., datë 30.01.2025 me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 13 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 824 Prot.
12

Patos më 20.03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024” Armand Ahmetaj – Kjo pikë është një detyrim ligjor për tu shprehur me vendim. Kemi të bëjmë me veprimtarinë e këshillit bashkiak gjatë vitit 2024. Materialet ju i keni lexuar, nëse është e nevojshme ne i lexojmë përsëri.

Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e tetë Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024”

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smeroll Kozaj
Erika Myrtaj
Istvan Veleci

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 812 / Prot.
12

Patos më 20.03.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024”.

Armand Ahmetaj- Shqyrtimi i pikës nëntë është e njehta fushë të themi, detyrim ligjor i këshillit

Artan Velçani – propozoj të kalojmë direkt në votim.

Armand Ahmetaj- Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e nëntë Projekt-vendim “Për miratimin e Raportit të Transparencës për procesin e Vendimarrjes së Këshillit të Bashkisë për vitin 2024”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 13 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerold. Kozaj
Eshita Myrtaj
Artan Velçani

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 829/4 / Prot.

Patos më 20.03.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 19.03.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Informacion për Inventarët jashtë përdorimit nga Agjencia e Shërbimeve Publike.

Xhevaire Gjoka - Relaton Informacionin e paraqitur me shkrim-
Përshëndetje të gjithëve!

Ju informojmë mbi situatën për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarëve të 2024 të Agjencisë të Shërbimeve Publike bazuar në vendimin e këshillit bashkiak numër 28 datë 18.05 2018 për miratimin rregullore të menaxhimit të aktiveve udhëzimi numër 30 për menaxhimin e aktive në njësitë e sektor publik agjencia e shërbime publike kanë ndjekur të gjitha hapat e duhur në respektim të këtyre udhëzimeve dhe ligjeve për nxjerrjen përdorimit të materialeve të cilat nuk shërbejnë më pasi janë jashtë funksionit të përdorimit dhe mendohet që vlerat e propozuar nga komisionet pasi kanë hartuar dhe procesverbalet përkatëse është në vlerën katër milionë 318 mijë e 385 lekë e ndarë në llogari të ekonomike në inventarin informatikë në vlerën 397,649 lekë, inventarë të imët 1,468,163 lekë, vegla pune 2,397,683 lekë dhe inventare ikupro 54,890 lekë.

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Meqë skemi propozoj të mbyllim mbledhjen.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smeret Kozaj
Ertan Myrtaj
Artan Velica

KRYETAR
Armand Ahmetaj